REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCA CIVILE

MIRATOHET
KRYETARI
MIFTAR DAUTI

Krumë, më 06/10/2025

Nr3567Prot

# PLAN - GADISHMËRIE
## PËR
## PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE DIMËRORE QË MUND TË SHKAKTOHEN NË RRETHIN E HASIT

**Qëllimi:** Marrja e masave paraprake për përballimin e fatkeqësive dimërore që mund të ndodhin në territorin e Rrethit te Hasit.

**Objektivi:** Përpilimi i Planit të Përgatitjes për fatkeqësi dimërore dhe rolin e strukturave të ndryshme shtetërore për zbatimin e tij.
Ndërhyrjen e menjëhershme për plotësimin e nevojave emergjente.
Rritjen e kapaciteteve në rastin e fatkeqësive.
Rritje e sensibilizimit publik lidhur me përgatitjen ndaj fatkeqësive.

**Drejtimin ku do të veprohet për realizimin e Planit të Gadishmërisë:**
Ringritjen e strukturave të menaxhimit të situatave.
Sistemin e informacionit.
Vlerësimin e dëmeve.
Koordinimin me strukturat qeveritare e joqeveritare.
Ndërhyrjen në familje apo grup familjesh më në emergjencë.

**I.SHTRIRJA DHE NDIKIMI I DUKURIVE TË MUNDSHME NË RRETHIN E HASIT**

**Rrethi i Hasit shtrihet në pjesën Verilindore të Republikës së Shqipërise. Ka një sipërfaqe prej 399.62 km katrore e popullsi 22 987 banorë.**

Rrethi përbëhet nga kater njesi administrative Krume,Golaj,Fajza dhe Gjinaj.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

**Popullsia në shkallë Rrethi:**
Numri i banorëve është 22,770 banorë (sipas të dhënave të marra nga Gjendja Civile Has).

**Rrethi i Hasit kufizohet në vijë kufitare shtetërore me Kosovën km.**
Brenda territorit të vendit kufizohet me Rrethin e Tropojes dhe Qarkun e Kukësit.
Territori i Rrethit te Hasit është rajon i thyer malorë dhe i banuar nga lartësitë 370 m deri në 450 m mbi nivelin e detit.

## II.INVENTARI I BURIMEVE PËRKATËSE

Për përballimin e fatkeqësive do të bazohemi kryesisht në strukturën shtetërore. (bashki, dëgët teritoriale, ente publike, OJF, subjekte aktive e organizma të tjera shtetërore)

### A. AKSET RRUGORE QË PËRSHKOJNË RRETHIN

### AKSET RRUGORE NACIONALE

**Rrethi jonë përshkohet nga 66.3 km rrugë nacionale.**
Strukturat menaxhuese të rrugëve nacionale të Rrethit tonë janë pjesë përbërëse në Drejtorinë e Rajonit Verior me qendër në Shkodër.
Aktualisht Rrethi i Hasit për monitorimin e ndjekjen e problemeve të akseve rrugore nacionale, si strukturë drejtuese ka Sektorin Has me përbërje: 1 Përgjegjës e 4 Inspektor nga nje për çdo Njesi Administrative.
Nga ristrukturimi i këtyre strukturave të gjitha akset rrugore nacionale mirëmbahen nga sipërmarrës privat.
Nga ana e Firmave kontraktore janë marrë e po merren masat e nevojshme, për përgatitjen e periudhës dimërore.
Sipas informacioneve të marra drejtëpërsëdrejti drejtuesve të firmave kontraktore këto akse rrugore janë të dhëna të gjitha me performancë.

Inventari i akseve rrugore nacionale i përket Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër përbëhet nga akset e paraqitura në Tabelën e mëposhtme, ku një pjesë e tyre ndiqen nga DRV Shkodër, një pjesë janë segmente që i përkasin Projektit të Bankës Botërore që ndiqen nga ARRSH dhe pjesa tjetër i përket Koncesionit të Rrugës së Kombit.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

## INVENTARI I RRJETIT RRUGOR BASHKIA HAS

| | I. GOLAJ | Bashkia Has | Gjatesia (Km) | E asfaltuar (Km) | E pa asfaltuar (Km) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | R.N.13 –Helshan B.Liqenit | 7 | | Çakell |
| 2 | | Helshan - Kosturr | 4 | | Çakell |
| 3 | | Qender Helshan - | 2.8 | | Çakell |
| 4 | | R.N.13 - Perollaj | 4.2 | Asfalt | |
| 5 | | Letaj - Peraj | 2 | | Çakell |
| 6 | | Peraj - Zgjeç | 4 | | Çakell |
| 7 | | Plepa – Pla i Pates | 5 | | Çakell |
| 8 | | Golaj Qender – Unaze Dautaj | 4.8 | Proçes Asfalti | |
| 9 | | R.N.13 Dobrune | 7.9 | Asfalt | |
| 10 | | R.N.13 - Nikoliq | 5 | | Çakell |
| 11 | | Letaj – Dobrune | 4.5 | | Çakell |
| 12 | | R.N.13 - Vlahen | 6 | Asfalt | |
| 13 | | Vlahen – Muhader | 4 | | Çakell |
| 14 | | Nikoliq - Vlahen | 3.9 | | Çakell |
| 15 | | Golaj – Fabrike e Pasurimit | 3 | | Çakell |
| 16 | | Bregu i Vlahnës-Ngjeç | 2.5 | | Çakell |
| | II.QENDËR KRUME | | | | |
| 17 | | Krume - Cahan | 11 | | Çakell |
| 18 | | Cahan - Dajç | 4 | | Çakell |
| 19 | | Cahan - Kishaj | 3.4 | | Çakell |
| 20 | | RN13-Rad-Gec | 2.9 | | Çakell |
| 21 | | RN13 - Gajrep | 3.5 | | Çakell |
| 22 | | RN13 - Zahrisht | 5 | Asfalt | - |
| | III. FAJZA | | | | |
| 23 | | Sefoll – Fajza | 4 | | Çakell |
| 24 | | Fajza – Liqe I Kuq | 9 | | Çakell |
| 25 | | Tregtan - Brenoge | 7 | | Çakell |
| 26 | | Tobel – Metaliaj | 3 | | Çakell |
| 27 | | Tobel- Myç Has | 6.5 | Asfalt | - |
| 28 | | Metaliaj – Bregu I Liqenit | 4 | | Çakell |
| 29 | | Metaliaj - Beg | 2 | | Çakell |
| 30 | | Vranisht - Fajza | 4.5 | | Çakell |
| 31 | | Vranisht Qender - Mazrek | 3 | | Çakell |
| 32 | | Vranisht –Bregu i Krumes | 3.5 | | Çakell |
| 33 | | Bregu i Krumes – Pla i Krumes | 4 | | Çakell |
| 34 | | Vranisht - Cenali | 2 | | Çakell |
| | IV.GJINAJ | | | | |
| 35 | | RN13 - Gjinaj | 4 | | Çakell |
| 36 | | Gjinaj – Pus I Thate | 3.5 | | Çakell |
| 37 | | Gjinaj - Domaj | 7 | | Çakell |
| 38 | | Domaj- Pogaj | 5 | | Çakell |
| 39 | | Kishaj-Mariç-Pogaj | 4.2 | | Çakell |
| | | SHUMA TOTAL | 176.6 Km | | |



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

## SISTEMI RRUGOR NË ADMINISTRIM TË BASHKIVE

**Bashkia Has:**

**Bashkia Has ka 39 segmente rrugore me 176.6 km.**

Po punohet nga Bashkitë në Zbatim të Planit të Veprimit, për marrjen e masave në përballimin e Emergjencave Civile, si në shfrytëzimin e rezervave ashtu dhe në kontaktimin e lidhjeve të marrëveshjeve me të tretë, për kontratat e domosdoshme që kërkohen në përballimin e emergjencave dimërore.

**Punë paraprake:**
Mbajtjen në gadishmeri të mjeteve.
Sigurimi i bazës materiale.
Mbushja e gropave.
Pastrimi i kanaleve anësore e turbinave.
Hartimi i Projekt-Preventivave parashikues.
Grafiku i shpërndarjes së mjeteve me të tretë.

**Problematike janë akset rrugore rurale si:**
Rruga Krumë-Cahan-Kishaj
Rruga Gjinaj-Domaj-Pogaj
Rruga Vlahen.

## KAPACITETET

**Nga Detashmenti i Mbështetjes Rajonale (DMR):**
Një grup i gatshëm i përbërë prej 10-15 veta.
2 automjete tip "IVEKO" për transport deri në 2 ton.
1 automjet 4x4 "Shevrelet.
1 autoambulancë.
1 autozjarrëfikëse me ekuipazh të kompletuar.
1 borëpastruese.

**Drejtoria Vendore e Kufirit e Migracionit**

Grup i gatshëm prej 9-18 punonjësish.
3 automjete për të ardhur në ndihmë në rast emergjencash.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

**Drejtoria e OSHEE-së Njësia HAS**

Furistrada 1(pesë)
Kamionçinë 1(një)
Grup punonjësish prej 26 personash për mbajtjen në gadishmëri të të gjitha linjave elektrike.

**Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor**

46 punonjës

**Drejtoria e Shërbimit Spitalor**

Personel 31.
Autoambulanca 3.
Numri i shtreterve 34.

**AKU**
Inspektor 2
Automjet 1

# GJENDJA

## E BURIMEVE NJERËZORE DHE LOGJISTIKE AKTUALE NË BASHKINË HAS, NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT, QË MUND TË ANGAZHOHEN NË RASTE EMERGJENCE PËR SEZONIN VJESHTË-DIMËR-PRANVERË 2024-2025

| Bashkia Has<br><br>Emërtimi i<br><br>subjekteve publike,private dhe organizata ve të ndryshme. | Burime njerëzore dhe logjistike | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Personel | Ekskavatore | Fadroma | Vinca | Mjete veteshkarkuese | Mjete zjarrëfikëse | Borë pastruese | Varka/skafe | Pompa thithëse uji | Autoambulanca | Laborator për kryerje analizash ushqimi dhe uji të pijshëm | Numri i shtretërve për evakuim, spitale, hotele, konvikte etj | Ambjente të lira për evakuim (sipër m2) | Çadra për strehim copë | Traktor | Pompa shpine | Autobot uji | Makina shpëtimi | Gjenerator | Makina trensporti të llojeve të ndryshme | Të tjera autobusa, fugona, taksi | Të tjera |
| Bashkia Has | 153 | 9 | 5 | 5 | 2 | 1 | 10 | | 2 | 4 | | 138 | | | 1 | 5 | 1 | 1 | 1 | 11 | | 8 |
| TOTALI | 153 | 9 | 5 | 5 | 2 | 1 | 10 | | 2 | 4 | | 138 | | | 1 | 5 | 1 | 1 | 1 | 11 | | 8 |



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

## LLOGARITJA E KONSUMIT USHQIMORË PËR PERIUDHËN NJË MUJORE

| Nr | Bashkia | Nr.i Popullsisë banorë | Norma mujore e konsumit për frymë në kg | Konsumi për një muaj ton |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Has | 22 987 | 15 | 344.8 |

## GJËNDJA E MULLINJVE DHE FURRAVE TE BUKËS

| Nr | Bashkitë | Mulli bloje | Fabrikë mielli | Furra buke |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Has | 7 | 1 | 4 |

## PËR PËRBALLIMIN E BAZËS USHQIMORE TË BLEKTORISË

**Rrethi i Hasit aktualisht ka këtë inventar të krerëve në blektori, shpendari e bletari:**

**Bashkia e Hasit**

- **Gjedhe** **krerë** **5 124**
- **Të imta** **krerë** **6875**
- **Njëthundrak** **krerë** **215**
- **Shpendë** **krerë** **44500**
- **Bletë** **koshere** **875**

## NEVOJAT DHE SIGURIMI I BAZËS USHQIMORE

### BASHKIA E HASIT

| Emërtimi | Nevojat (ton) | Sigurimi (ton) | Nevojat ton Nj/Q | Sigurohen ton Nj/Q | Realizimi % |
|---|---|---|---|---|---|
| Bare i thatë | 10 930 | 8 230 | 4 372 | 3 293 | |
| Kashte misri | 2 970 | 2 400 | 742 | 600 | |
| Kashtë të lashtash | 1 184 | 850 | 296 | 212 | |
| Gjethe dushku | 1 615 | 1 615 | 485 | 485 | |
| **Totali** | **16 699** | **13 095** | **5 895** | **4 590** | **78.2 %** |

Diferencat për nevoja plotësohen nga fermerët me blerje në pikat e tregëtimit të bazës ushqimore.

**Shërbimi Shëndetësor**



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Në shkallë Rrethi është kjo strukturë shëndetësore e cila do të shërbeje për rastet e emergjences.

**HASI**

| | |
|---|---|
| Spital Civil | 1 |
| Kapaciteti shtretër | 34 |
| Qëndra Shendetësore | 3 |
| Ambulanca | 28 |

**Furnizimi me ujë të pijshëm**

Sh.a Ujësjellësi Has për rrethin e Hasit.
Ujësjellësi i rrethit të Hasit e bën furnizimin me ujë të popullatës e bëjnë me ngritje mekanike.
Nga Sh.a Ujësjellës-Kanalizimet, po punohet për të marrë masat e nevojshme për periudhën dimërore me qëllim sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës.
Janë marrë masat për furnizimin me mjete ngrohëse dhe me materiale dizinfektuese të ujit të pijshëm për periudhën dimërore.
Problematik mbetet rrjeti i amortizuar i Ujësjellësave e gjendja e mjeteve dhe pamundësia financiare për të ndërhyrë.
Ujësjellësi i rrethit Has funksionon në sajë të energjisë elektrike ku i është lënë detyrë njësisë vendore Bashkisë Has që të marrin masat e duhura në mungesë te energjisë elektrike, për vendosjen në punë të gjeneratorëve.

**KËTO INSTITUCIONE KANË NË DISPOZICION**

**Ujesjellesi HAS**

Punonjës 26
Fouristrade 1
Iveko 1

Kanë mungesa në gjendje materiale të pjesëshme për ndërhyrje emergjente si tuba, gjenerator dhe pompë.

**Furnizimi me energji elektrike.**

Furnizimi me energji elektrike në Rrethin e Hasit bëhet nga OSHEE:
Agjensia Has

**Për problemet e arsimit**

Në kushtet e Emergjencës Civile Dimërore mund të bëhet bllokimi i aktivitetit të mësimdhënies në shkollat si më poshtë:

**Bashkia Has.**

Bashkia Qendër: Cahan, Mujaj.
Nj. Adm Gjinaj: Pus i Thatë, Pogaj e Kishaj.
Nj. Adm Golaj: Vlahen, Dobrune, Helshan.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Për përballimin e situatës dimërore nga drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me njesitë administrative, për periudhën dimërore janë marrë masat, për furnizimin me lëndë ngrohëse të objekteve shkollore.
Në rast bllokimi total të këtyre rajoneve në zbatim të akteve normative, me propozim të drejtorit të shkollës apo organit vendor nga Drejtoria Arsimore nxirret urdhëri për pezullimin e mesimdhënies sipas afateve të përcaktuara.
Me nxjerrjen e këtij urdhëri njoftohet menjëherë Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve.
Kjo periudhë do të zëvëndësohet në periudhën e verës.

**Akset rrugore me risk të lartë emergjente rreshqitje dhe bllokim nga reshjet e deborës:**

**Bllokimi i segmenteve të rrugëve nacionale:**

Plepa - Qafë Prush

**Rënie masive të gurëve :**

Krumë - Kukës
Krumë – Kam

**Bllokim i rrugeve bashkiake :**

Krumë – Cahan
Krumë - Vlahen
Krumë - Gjinaj
Krumë - Helshan
Krumë - Dobrune

**Rrëshqitje të rrugëve nacionale :**

Krumë – Skatinë

**Rrëshqitje të rrugëve rurale në :**

Qaf Tobli – Metaliaj
Krumë – Cahan

Temperaturat e ulëta rrezikojnë ngrirjen e tubacioneve të ujit të pijshëm për:

Rrethin e Hasit 125 familje

Bllokimi i tubacioneve mund të jetë i pjesshëm në segmente të veçanta të cilat janë në afërsi të sipërfaqes së tokës.
Ky fenomen është evident për linjat dytësore.
Temperaturat e sidomos ngricat bëjne të domosdoshëm sigurimin në vazhdimësi të rrymës elektrike.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

## POPULLSIA NË RREZIK

**Bllokimi total i popullsisë sipas fshatrave në Njesite Administrative:**

### BASHKIA E HASIT

Bashkia Q. Krumë: Fshatrat Gajrep
Cahan
Mujaj

Nj.Ad Gjinaj : Fshatrat: Pusi i Thatë
Pogaj
Kishaj

Nj.Ad Golaj : Fshatrat Vlahen
Dobrunë

**Popullsia e rrezikuar rreth 2112 banorë.**

## IV.ORGANIZIMI, PËRGJEGJËSITE DHE BASHKËPUNIMI

**a.Shërbimet që do të përfshihen në kushtet e emergjencës do të jenë:**

1. Sektori i Bordit te Kullimit në Bashkinë Has.
2. Sektori i Rrugëve Rurale në Bashkinë Has.
3. Njësia Vendore e Shëndetit Publik.
4. MZSH-ja.
5. DMR-ja.
6. Drejtoria Rajonale e Tatim Taksat.
7. Drejtoria Rajonale Doganore.
8. Drejtoria e ujësjellësit Has.
9. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit.
10. Kryqi i Kuq dega: Has.
11. Autoriteti Rrugor Shqipëtar.
12. Biznesi Privat.
13. Komuniteti.

**Puna që do të bëjnë:**

Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër do të bëjë planizimin për organizimin e punës për mbajtjen në gadishmëri të akseve nacionale.
Prioritet kryesor do të ketë aksin që lidh Kosovën me qendrën e vendit e konkretisht akset Qaf-Prush-Krumë-Kukës.
Me strukturat e saj nëpërmjet Firmave Kontraktore do të ndërhyhet në rastet e fatkeqësive (bllokim e shembje të rrugëve) për të rivendosur gjendjen.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Do të monitorojë gjatë gjithë kohës aktivitetin e firmave kontraktore të cilat kanë akset rrugore nacionale.
Me mjetet që kanë në dispozicion do t'i japë ndihmë strukturave të akseve rrugore në Bashki në momentet që do të kërkohet nga Komisioni i Emergjencës Qarkut.

Bashkia do të planizojë në aktivitetin e saj, për mbajtjen në gadishmëri rrugët rurale duke realizuar lidhjen e Njësive Administrative me qendrat e bashkive.

Bashkia të bëjë vlerësimin e përllogaritjen në mënyrë të vazhdueshme të gjendjes së ushqimeve të domosdoshme, vijueshmërinë e furnizimit me ushqimet bazë të popullatës.

Gjëndjen e blegtorisë dhe masat e marra për rezervat e bazës ushqimore për sezonin dimërore.

Bashkia do të mbaje nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marre masat përkatëse për sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit gjatë gjithë kohës do të ushtrojë kontroll mbi cilësinë e ushqimeve si ato që tregëtohen si dhe ato që konsumohen. Nën vëmendje te veçantë do të ketë mallrat që vijnë nga jashtë e kontrollin e cilësisë së ndihmave ushqimore.

Drejtorita Rajonale e Shendetit Publik e Spitalor do të jenë në gadishmëri për përballimin e emergjencave shëndetësore si në sherbimet spitalore deri tek qëndrat shëndetsore.

Krijimin e rezervave me medikamente shëndetesore si në shërbimet spitalore deri tek qëndrat shëndetesore.
Nga spitalet të mbahet në gadishmeri 30 shtretër për përballimin e fatkeqesive të cilat mund të shkaktojnë dëme në njerëz.
Të mbahet në gadishmëri të plotë reparti i urgjencës me llogjistiken e nevojshme.

Drejtoria Vendore e Policise Rrethit do të mbajë nën kontroll rendin e qetësinë publike në shkallë rajoni dhe do të japë kontributin e saj në mjete dhe njerëz në raste fatkeqësish.

Të marrë nën kontroll rajonin në të cilin ndodh fatkeqësia duke marre pjesë drejtëpërdrejtë në operacionet e ndërhyrjes.
Do të mbajë në kontroll të vazhdueshëm akset rrugore duke ushtruar kontroll të vazhdueshëm për levizjen e mjeteve të komunikacionit.

DMR: Do të marrë pjesë në operacionet e shpëtimit dhe ato humanitare.

Do te mbahen nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse për sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

Bordi i Kullimit do të mbajë nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse për sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

OSHEE në shkallë Rrethi do të mbajë në gadishmëri rrjetin me furnizim të energjisë të popullatës në marrjen e masave në eleminimin e avarive që mund të ndodhin.

Sh.a Ujësjelles: do të mbajnë në gadishmëri linjat me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës të prekur nga fatkeqësia duke ndërhyrë me grupet e gadishmërisë, për eleminimin e emergjencave në këtë shërbim publik.


*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

MZSH-ja do të marrë pjesë në veprimtaritë e kërkim shpëtimit në ato rajone ku ka fatkeqësi.

Kryqi i Kuq Rajonal si partner kryesor do të bashkërendoje punën me komisionin e emergjencës në shkallë Rrethi për të vepruar në veprimtaritë humanitare.

Rezervat e Shtetit bëjnë programimin e punës për krijimin e shpërndarjen e rezervave materiale në zonat e prekura nga fatkeqësitë.

Tatim-Taksat do të ndjekin me përgjegjësi kontroll të rreptë të abuzuesëve të çmimeve kryesisht atyre ushqimore.

Drejtoria Rajonale Doganore do të punojë për lehtësimin e procedurave doganore për rastet e dhënies së ndihmës nga jashtë.

Biznesi privat do të punojë për krijimin e rezervave logjistike në përballimin e fatkeqësive.

Shërbimi Metrologjik do të japë dy herë në ditë informacion për situatën sinoptike.

Me median do të koordinohet puna për pasqyrimin e aktiviteteve të shërbimeve e sensibilizimin e opinionit publik në përballimin e fatkeqësive.

## C. PËR BASHKËPUNIMIN ME RRETHET FQINJË.

Organizimi i bashkëveprimit ndërmjet qarqeve realizohet kryesisht me Qarkun e Kukësit dhe Rrethin e Tropojes dhe një pjesë të komunave të Kosovës që janë përgjatë kufirit shtetëror, për veprimet të përbashkëta e ndihmë të ndërsjelltë.

Për mbajtjen në gadishmëri të rrugës nacionale Krumë-Kukës, Krumë-Tropoje dhe Qaf-Prush-Krumë.

Për Njësitë Administrative Golaj do të realizohet bashkëveprimi në komunën e Gjakovës për dërgimin e të sëmurëve të fshatrave kufitare me Gjakovën.

Bashkëveprimi do të jetë me të gjithë fqinjët për dhënie e marrje informacioni reciprok.



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

**a. Anëtarët e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Rrethit te Hasit.**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Miftar Dauti | Kryetari i Bashkisë | Kryetar |
| 2 | Isuf Sefolli | Kryetar i Këshillit Bashkiak | Sekretar |
| 3 | Arberie Rada | Drejtoresh e Mbrojtjes Civile | Anëtarë |
| 4 | Fatos Ahmati | Përgjegjës i Emergjencave Civile | Anëtarë |
| 5 | Zenel Sheta | Zv/Kryetar i Bashkisë | Anëtarë |
| 6 | Urim Dauti | Adm.Nj.Adm.Golaj | Anëtarë |
| 7 | Sadik Dajçi | Adm.Nj.Adm.Fajza | Anëtarë |
| 8 | Pellumb Thaçi | Adm.Nj.Adm.Gjinaj | Anëtarë |
| 9 | Fadil Muja | Inspektor i Policisë Bashiake | Anëtarë |
| 10 | Astrit Përlesha | Shefi i Komisariatit Has | Anëtarë |
| 11 | Jetmir Lala | Përgjegjës i MZSH Has | Anëtarë |
| 12 | Islam Lisha | Përgjegjës i Bordit Kullimit | Anëtarë |
| 13 | Fadil Dauti | Përgjegjës i Sektorit Pyjor | Anëtarë |
| 14 | Bledar Lushi | Drejtor i Shërbimeve Publike | Anëtarë |
| 15 | Izet Malaj | Përgj i Sek.Rrugëve Rurale | Anëtarë |
| 16 | Shaban Peka | Drejtor i Spitalit | Anëtarë |
| 17 | Flutura Aliaj | Përgjegjës Sek. Arsimit, Kultures | Anëtarë |
| 18 | Erisa Ferizolli | Përgjegjëse e Sektorit Juridike | Anëtarë |
| 19 | Novruz Bardhoshi | Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikes | Anëtarë |
| 20 | Sahit Meshi | Drejtor i Sektorit Financës | Anëtarë |
| 21 | Kujtim Derri | Perfaqësues i Kryqit të Kuq | Anëtarë |
| 22 | Ferit Mazrreku | Drejtor SH.A Ujësjellesi | Anëtarë |
| 23 | Din Poga | Përgjegjës i OSHEE | Anëtarë |
| 24 | Perparim Ahmati | Shefi i Stacionit PKK Qaf Prush | Anëtarë |
| 25 | Arjana Ukperaj | Drejtore e Shëndetit Publik | Anëtarë |
| 26 | Ardjan Xhaferi | Drejtori i Zyres Arsimore Has | Anëtarë |
| 27 | Imer Dauti | Drejtor i Arsimit/Kultures/Turizmit, Rinise dhe Sportit | Anëtarë |
| 28 | Fatmire Qema | Përgjegjëse e Sektorit Taksave | Anëtarë |
| 29 | Dritan Çerkezi | Përgjegjës i Sektorit Ndihmës Ekonomike | Anëtarë |

**GRUPET E PUNËS PËR MONITORIM NDJEKJE E ZBATIM TË DETYRAVE NË PËRBALLIM TË SITUATAVE TË EMERGJENCËS CIVILE**

**Nga administrata e Bashkise do të krijohen grupet e punës:**

**Grupi Informacionit**

| | | |
|---|---|---|
| Arberie | Rada | Drejtoresha e Mbrojtjes Civile. |
| Novruz | Bardhoshi | Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës. |
| Bledar | Lushi | Drejtor i Shërbimeve |
| Islam | Lisha | Përgjegjës i Bordit të Kullimit. |
| Izet | Malaj | Përgjegjës i Sektorit Rrugëve Rurale. |

**Grupi i vlersimit:**

| | | |
|---|---|---|
| Novruz | Bardhoshi | Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës. |
| Sahit | Meshi | Përgjegjës i Sektorit Ekonomik. |



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

**Grupi i ndjekjes dhe shpërndarjes së ndihmave:**

| | | |
|---|---|---|
| Arberie | Rada | Drejtoresha e Mbrojtjes Civile. |
| Sahit | Meshi | Përgjegjës i Sektorit Ekonomik. |
| Rrahman | Baraku | Magazinier i Bashkisë Has |

**c. Masat për paralajmërim:**

Fenomenet që mund të shkaktojnë emergjenca në Rrethin e Hasit janë rreshjet e mëdha të dëborës, temperaturat e ulëta, suferinat.

Vëzhgimi do të bëhet nga Kryetarët e fshatrave e personeli i gadishmërisë se institucioneve.

Paralajmërimi i hershëm bëhet nga shërbimi sinoptik i vendosur në Meteor Kukës.
Nga qendra sinoptike do të bëhet njoftimi i kryetarit e zv. kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile Qarkut.

**VI. Komunikimet:**

Mënyra e komunikimit midis niveleve të ndryshme do të bëhet me telefon kabllor e mobil.
Do të shfrytëzohet ndërlidhja me radio nga Drejtoria e Policisë me Komisariatet.
Gjithashtu do të shfrytëzohet ndërlidhja me strukturën e MZSH-së.
Komunikimi me mediat do të bëhet me komunikatat e shtypit të zëdhënësit të komisionit si dhe të konferencës të shtypit të organizuar nga kryetari apo zv. kryetarët e komisioneve.

**VII. EVAKUIMI DHE SHPËTIMI.**

Në rastet e krijimit të fatkeqësive nga orteqet apo rrëshqitjet e tokës e cila shoqërohet me pasoja në njerëz do të veprohet nga kjo strukturë operacionale.

**Drejtues operacioni:**

**Drejtori i Shërbimeve Publike**
MZSH-ja.
Policia e Shtetit.
Shërbimi i Ambulancës.
Kryqi i Kuq.

**VIII. EMERGJENCA SHËNDETESORE**

Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik do të përballojë nëpërmjet infrastrukturës së këtij shërbimi në Bashkinë e Hasit 3 Q.SH.
Do të veprojne reparti i urgjencës Has.

**IX. PUNIMET URGJENTE PËR RIPARIMIN E MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE PUBLIKE.**

Ndërhyrjet më emergjente që duhet të bëhen në infrastrukturë rrugore janë:
a. Sistemimi e rehabilitimi i rrugëve nacionale:


*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

b. Rrugët bashkiake:
Krume-Cahan, Kishaj, Mujaj.
Krume-Vlahen, Nikoliç, Dobrunë.
Krume-Gjinaj. Pogaj

## X. DËRGIMI DHE SHPËRNDARJA E NDIHMAVE:

**Magazinimi:**
Magazinimi i mallrave do të bëhet kryesisht në qendrën e qytetit Krumë.
Nga biznesi privat mbahen në magazinat e tyre.
Artikuj ushqimore e jo ushqimore do të grumbullohen në të njëjtat magazina.

**Shpërndarja:**
Shpërndarja e artikujve ushqimor e jo ushqimor do të bëhet nën drejtimin e grupeve të shpërndarjes së ndihmave.
Shpërndarja do të bëhet nga Bashkia.
Nga Bashkia do të bëhet shpërndarja e drejtpërdrejte në Nj.Administrative e kjo e fundit nëpër fshatrat nepërmjet kryetarëve të fshatrave.

**Vëzhgimi:**
Do të bëhet nga anëtarët e Komisionit MC të Bashkisë.
Për çdo dërgesë do të ketë përfaqësues të bashkisë.

**Raportimi:**
Raportimi do të bëhet nga kryetarët e Njësive Administrative e të bashkive.
Për problemet e dala njoftohet menjëherë Kryetari i Komisionit MC të Rrethit.

## XI. VENDET E PËRKOHSHME PËR STREHIMIN:

Për strehim do të përdoren Konvikti.
Hoteleritë në qytete apo edhe godinat në disa shkolla në fshatra.
Shtëpitë e braktisura si rezultat i levizjes së popullsisë në drejtim të qendrave urbane.

## XII. SHËNDETI PUBLIK:

Do të jetë në vëmëndjen e të gjithë këtyre institucioneve qe lidhen me këto shërbime.
Ushqimet do të mbahen nën kontrollin e vazhdueshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
Uji i pijshëm do të jetë nën mbykqyrjen e vazhdueshme të epidemiologëve dhe punonjësve të tjerë te ujësjellësave.
Higjena publike do të ndiqet nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, duke ndjekur gjatë gjithë kohës gjendjen e shëndetit të popullatës.

## XIII.RUATJA E RENDIT PUBLIK E QETËSISE PUBLIKE.

Nga Komisariati i Policisë në rrethe në zbatim të Ligjit "Për Policine e Shtetit" me Plane Veprimi do të mbajnë rendin e qetësinë publike.
Gjatë gjithë kohës do të bashkëveprohet me Kryetarin e Komisionit të Emergjencave Civile të Rrethit, për problemet e dala dhe masat që do të merren për eliminimi e tyre.
Automjete të Policisë do të shërbejnë për t`u ardhur në ndihme popullatës në nevojë.
Punonjës Policie për menaxhimin dhe përballimin e këtyre situatave.
Në qytete do të veprojnë forcat e specializuara e të gadishmërisë.
Në Njësit Administrative inspektorët e zonave dhe policia bashkiake e komunale.


*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*

Në rastet e fatkeqësive nga Komisariati i Policise rrethit do të bëhet izolimi i zonës e marrje pjesë drejtëpërsëdrejti në operacionet e shpëtimit.
Në Bashkine Has do të angazhohen edhe punonjës Policie të Stacioneve Kufitare Qaf-Prush

## XIV.NEVOJAT PËR BAZË MATERIALE, KOSTOJA DHE PREVENTIVI.

Për përballimin e Emergjencave Civile Dimërore në Rrethin e Hasit janë këto nevoja:
Nevojat për furnizim me mallra ushqimore të popullatës së Rrethit për periudhën 1 mujore janë:

Bashkia e Hasit 344.8 ton.

Për organet vendore është i domosdoshëm e disponibël fondi financiar në Zërin e Emergjencave Civile në masën prej 4 %.

Në rezevat e shtetit është e domosdoshme krijimi i mallrave stoqe për ndihmë të menjëherëshme. Është e ripërsëritur domosdoshmëria që pranë Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile të rrethit të ketë një fond financiar rezervë, për përballimin e emergjencave dimërore.

## XV. KY PLAN-GADISHMËRIE GJATË GJITHË KOHËS DO TË RISHIKOHET DHE PËRPUNOHET NË PËRSHTATJE ME ZHVILLIMIN E FENOMENEVE TË FATKEQËSIVE DHE EMERGJENCAVE.

***Drejtoresha e Mbrojtjes Civile***

***Arberie Rada***

***Përgjegjësi i Emergjencave Civile***

***Fatos Ahmati***



*Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
*Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al*